



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 9002 Prot.

Lezhë, më 7 . 7 . 2023

PROJEKT-VENDIM

Nr _____, Datë _____ .07.2023

**PËR
DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 54, DATË 28/04/2020 "PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË"**

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; neni 8, pika 2, neni 9 pika 1.1 gërma "b" dhe "d", neni 53, neni 54 gërma "k", Kryesia e Këshillit të Bashkisë Lezhë;

Propozon :

1. Në rregulloren e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë miratohen ndryshimet e mëposhtme:

Në nenin 7, pika 2.f riformulohet: "Këshilli në përgjegjësinë e tij për miratimin e mënyrës dhe rregullave të votimit për përbërjen e kryesisë së fshatit, si dhe në përcaktimin e rregullave të përgjithshme të organizimit e të funksionimit të këshillave komunitarë të lagjeve, mundëson për aq sa është e mundur kërkesat e ligjit për barazinë gjinore"

Në nenin 7, pika 11 shtohet në fund: "Grupi nismëtar i Këshilltarëve që thërrasin Mbledhje e Parë duhet të jene jo me pak se 1/3 e Këshilltarëve të sapozgjedhur"

Në nenin 15, pikat 1,2,3,4, 7 "Sekretari" zëvendësohet me "Drejtuesi i mbledhjes"

Në nenin 15, pika 6 shtohet në fund fjalia: "Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë.

Në nenin 15, pikat 17,18,19 Hiqen

Në nenin 28, pika 2 fjalia e parë riformulohet: "Numri minimal për formimin e një grupi politik është pesë këshilltarë"

Në nenin 28, pika 4 riformulohet: "Grup i përzier i këshilltarëve mund të konstituohet me këshilltarë që vijnë nga lista zgjedhore me më pak se pesë anëtarë të zgjedhur ose këshilltarë që janë larguar nga grupe të tjera Këshilltarësh"

Në nenin 31, pika 2 riformulohet: “Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë. Një këshilltar nuk mund të jetë anëtar i më shumë se dy Komisioneve të Përhershëm. Këshilli ndërmer masa të veçanta të përkohshme për të arritur për aq sa është e mundur pjesëmarrje të barabartë të gjinisë më pak të përfaqësuar në vendimmarrje.

Neni 33 riformulohet:

Emërtimi i Komisioneve të Përhershëm

Këshilli Bashkiak Lezhë ka 10 Komisione të Përhershme, ku bën pjesë çdo këshilltar përveç Kryetarit. Çdo këshilltar mund të jetë anëtar deri në dy komisione. Komisionet emërtohen si më poshtë:

1. Komisioni i Mandateve, Rregulloreve dhe Çështjeve Juridike (Rregulloreve, Qeverisjes së Mirë, Administratës, Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare, Etikës, Standarteve dhe Apelimeve) me 7 anëtarë.
2. Komisioni i Financës, Buxhetit dhe Zhvillimit Strategjik të Bashkisë (Buxhetit, Pasurive të Paluajtshme, Taksave dhe Tarifave Vendore, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik, Mbikqyrjes Financiare) me 7 anëtarë.
3. Komisioni i Shërbimeve Publike (Transportit, Strategjive Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve, Infrastrukturës) me 7 anëtarë.
4. Komisioni i Arsimit, Rinisë, Sportit dhe Turizimit (Arsimin, Rininë, Aktivitetet Çlodhëse dhe Argëtuese, Strategjitë e Turizmit) me 7 anëtarë.
5. Komisioni i Sigurisë Publike dhe Emergjencave Civile (Sigurinë Publike, Policisë Bashkiake, MKZ, Emergjencat Civile) 7 anëtarë.
6. Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Strehimit (Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Të Drejtave të Njeriut, Strategjitë e Strehimit) me 7 anëtarë.
7. Komisioni i Bujqësisë (Strategjitë e Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Menaxhimit të Ujrave, dhe Biodiversitetit, Zhvillimit Rural) me 7 anëtarë.
8. Komisioni i Kulturës dhe Titujve (Strategjitë e Zhillimit të Kulturës, Trashëgimisë Kulturore Titujt e Nderit dhe Emërtimet) me 7 anëtarë.
9. Komisioni i Urbanistikës, Programeve të Zhvillimit dhe Integritit (Urbanistika, Qeverisja Elektronike dhe Teknologjisë së Informacionit, Projekteve të Zhvillimit dhe Marrëdhëniet me Jashtë) me 7 anëtarë.
10. Komisioni i Shëndetit Publik, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (Strategjitë e mbrojtjes së Shëndetit Publik, Mbrojtjes së Mjedisit, Mbrojtjes së Konsumatorit) me 7 anëtarë

Në nenin 34, pika 8 riformulohet: “Komision i Përhershëm nuk mund të mbajë mbledhjen e tij në ditën që zhvillohet Mbledhja e Këshillit, përveç në rastin kur çështja që do të trajtohet nga mbledhja e Komisionit është një çështje që duhet me urgjencë për diskutim në mbledhjen e Këshillit të asaj dite.”

Në nenin 34, pas pikës 8 shtohet **pika 9** me këtë përmbajtje: “Për çështjet e miratimit të paketes fiskale dhe buxhetit të vitit mblidhen të gjithë komisionet për të diskutuar mbi fushat që mbulojnë. Vërejtjet apo propozimet e tyre depozitohen në komisionin që mbulon Taksat, Tarifat Vendore dhe Buxhetin”

Në nenin 175, pika 2 riformulohet: “Çdo fshat ndahet me vendim të Këshillit Bashkiak në lagje. Numri i lagjeve për çdo fshat është jo me pak se tre. Kjo në varësi të numrit të banorëve dhe historisë së përbërjes dhe fiseve në fshat. Në çdo fshat ngrihet Kryesia e Fshatit me numër sa lagje ka. Në çdo lagje zgjidhet një Anëtar i Kryesisë së fshatit në mbledhjen me zgjedhësit me të drejtë vote. Në çdo fshat Kryesia e Fshatit është organ këshillimor i Kryetarit të Fshatit dhe kryen dhe mbështet funksionet vetëqeverisëse të Bashkisë në fshatin e saj, si dhe kujdeset për zhvillimin ekonomik vendor, përdorimin e burimeve të përbashkëta dhe sigurimin e harmonisë sociale në fshat, dhe sipas përgjegjësive të përcaktuara nga Këshilli Bashkiak.

Në nenin 175, pika 4 riformulohet: Zgjedhja, organizimi, funksionimi, financimi dhe ndërverprimi i strukturave komunitare si: Kryetari dhe Kryesia e Fshatit, Këshilli Komunitar dhe Ndërlidhësi Komunitar bëhen sipas kësaj rregulloreje dhe rregullores së veçantë të miratuar nga Këshilli Bashkiak si dhe vendimit të posaçëm të Këshillit Bashkiak për zgjedhjet e këtyre strukturave.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryesia e Këshillit Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Ndue LULI

